



Programi Kombëtar i Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Shqipërisë

FINALJA E LABORATORIT TË DEBATIT UNIVERSITAR

26 Maj 2023

16:00 – 17:30

Kongresi Rinor Kombëtar,

Bulevardi Zogu i Parë, Rr. Papa Kristo Negovani, Pall.Li-Em, Shkalla 1, Kati 2, Salla Actival

Kontekst

SCiDEV implementon për të katërtin vit rradhaz Laboratorin e Debatit Universitar - Nga Fjala Tek Veprimi, i cili realizohet në kuadër të Programit Kombëtar të Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Shqipërisë me mbështetjen financiare të Fondacionit “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”.

Përgjatë këtyre 4 edicioneve, SCiDEV e ka shtrirë debatin universitar në 14 universitete publike e private nga 5 qytete të ndryshme të Shqipërisë, ku rreth 500 studentë kanë përfituar nga trajnimet e Programit të Zhvillimit të Kapaciteteve dhe janë përfshirë në përballjet debatuuese në rang institucioni dhe midis universiteteve të tjera të programit. Ndërthurja e kompeticionit të debatit me platformën e blogut universitar u dha mundësinë +100 studentëve dhe pedagogëve pjesë të programit të publikojnë shkrimet e tyre. Po ashtu, 22 të rinj kanë fuqizuar kapacitetet e tyre në kërkim dhe advokim përmes programit “Nga Fjala Tek Veprimi”. Përmes mentorimit, zhvillimit të kapaciteteve dhe mbështetjes financiare, të rinjtë aktivistë kanë realizuar përballje me politikëbërës, kandidatë për deputetë, prodhuar dokumente politikash mbi ndikimin e COVID-19 në arsimin e lartë, sfidat e digjitalizimit dhe ruajtja e trashëgimisë industriale.

Në këtë edicion të katërt, 12 universitete publike e private nga 5 qytete të Shqipërisë morën pjesë në kampionatin e debatit, nga ku Universiteti Ismail Qemali, Vlorë dhe Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë u kualifikuan në përballjen finale. Paralelisht me programin e debatit, 12 të rinj aktivë pjesëmarrës në Fushatën “Nga Fjala Tek Veprimi” kanë nisur procesin e mentorimit dhe mbledhjes së të dhënave për tema të lidhura me arsimin, punësimin, vendimmarrjen në arsim, digjitalizimin dhe diasporën, të cilat do të konsultohen me aktorë të shoqërisë civile, grupeve rinore, vendimmarrësve dhe biznesit në Forumin Rinor në 2-3 Qershor të organizuar nga SCiDEV në kuadër të Javës së Shoqërisë Civile me mbështetjen e Qendrës Kombëtare Burimore të Shoqërisë Civile dhe Fondacionit “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”.

Më 26 maj ju ftojme t’i bashkoheni finales së Edicionit IV të Debatit Universitar për t’u njohur më shumë me Laboratorin e Debatit Universitar, përvojat e pjesëmarrësve ndërvite si dhe për të zbuluar cili do të jetë skuadra fituese në këtë edicion.



AGJENDA

FINALJA E LABORATORIT TË DEBATIT UNIVERSITAR

26 Maj 2023
16:00 – 17:30

*Kongresi Rinor Kombëtar,
Bulevardi Zogu i Parë, Rr. Papa Kristo Negovani, Pall.Li-Em, Shkalla 1, Kati 2, Salla Actival*

Regjistrimi i pjesëmarrësve

| | |
|-------------|---|
| 16:00-16:10 | Fjalë përshëndetëse Blerjana Bino, Drejtor Ekzekutiv, SCiDEV Klodjan Seferaj, Menaxher Programi Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (tbc) |
| 16:10-16:50 | Debati final Universiteti Ismail Qemali, Vlorë vs Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë Moderatore: Jesmina Sengla, Koordinatore e Projektit |
| 16:50-17:10 | Panel diskutimi: Laboratori i Debatit Universitar ndër vite Eneja Allumuça, Alumna e Edicionit IV Lili Doda, Alumna e Edicionit IV Enri Koçi, Alumni Edicioni III |
| 17:10-17:20 | Sugjerime nga juria dhe shpallja e skuadrës fituese Blerjana Bino, Drejtor Ekzekutiv, SCiDEV Enxhi Lipa, Koordinatore Programi, Kongresi Rinor Kombëtar Dorina Gjipali, Trajnere e Programit të Zhvillimit të Kapaciteteve, Laboratori i Debatit Universitar dhe pedagoge, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës |
| 17:20-17:30 | Foto grupi |
| 17:30 - | Pritje për rrjetëzim informal dhe shpërndarje e certifikatave |